

Géraldine Jourde



KUVENDI  
NR 3588 DATE 20.11.23

## **REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

KUVENDI

## **GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE**

Nr. prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2023

**Lënda:** Depozitim projektligji.

**Drejtuar:** Znj. Lindita NIKOLLA

## **Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë**


*Enderuar Znj. Kryetare,*

Bazuar në nenin 81 pika 1, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenin 68, të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqesim projekligjin “**Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.**

Ju faleminderit.

## **DEPUTETET PROPOZUES**

1. Fadil Nasufi (Handwritten)
  2. Florence Speke (Handwritten)

3. Arkand Ballo 
4. Edoma Bilalić 
5. Bussin Cecar 
6. ANDREJ TAHIRI 
7. Ghpresa Marnoj 
8. Mirela Pitadić 
9. DENIS DELIU 
10. KODIANA SPAHIC 
11. Euslunica Zekić 
12. Edouard Adreco 



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Kuvendi**

**PROJEKT LIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_/2023

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 81/2017 “PËR ZONAT E MBROJTURA”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**KUVENDI**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtuar”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Pas shkronjës “ç” të nenit 4 shtohen shkronjat “d” “dh” “e” me përbajtje:

- “d) Parimi i përshtatshmërisë. Kategoria e një zone të mbrojtur duhet të ndryshohet nëse nga vlerësimi në një kohë të dhënë i saj rezulton se objektivat e përcaktuara dhe menaxhimi afatgjatë nuk përputhen me ato të kategorisë të caktuar;
- dh) Parimi i kategorizimit sipas objektivave. Përgjedhja e kategorisë së zonës së mbrojtur sipas këtij ligji duhet të kryhet në përputhje me objektivat kryesorë të shpalljes të secilës kategori të zonave të mbrojtura.
- e) Parimi i fleksibilitetit të menaxhimit. Zonat e mbrojtura menaxhohen nëpërmjet formave të ndryshme të menaxhimit. Secila prej kategorive të zonave të mbrojtura mund të administrohet/menaxhohet sipas çdo forme menaxhimi/administrimi, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.”

**Neni 2**

Pas nenit 4 shtohet nenit 4/1 me përbajtje si më poshtë:

**Neni 4/1**  
**Politikat mbi zonat e mbrojtura**

1. Politikat shtetërore në fushën e zonave të mbrojtura udhëhiqen nga Këshilli i Ministrave. Këto politika zbatohen nga ministria përgjegjëse për mjedisin, në ndërveprim me institucionet e tjera të qeverisjes qendrore e vendore, si dhe me shoqërinë civile.
2. Qëllimet strategjike të administrimit, ruajtjes dhe mbrojtjes së zonave të mbrojtura parashikohen në dokumentin e politikave strategjike të mbrojtjes së biodiversitetit.
3. Këshilli i Ministrave:
  - a) miraton plane për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e zonave të mbrojtura;
  - b) krijon institucione dhe subjekte juridike me propozim të ministrisë përgjegjëse për mjedisin;
  - c) miraton kalimin në administrim të zonave të mbrojtura, sipas parashikimeve të këtij ligji;
  - ç) ushtron çdo funksion tjetër të parashikuar në këtë ligj.

**Neni 3**

Pas nenit 4/1 shtohet nenit 4/2 me përmbajtje si vijon:

**Neni 4/2**  
**Funksioni i institucioneve publike**

1. Shteti siguron ruajtjen, dhe administrimin e zonave të mbrojtura, në zbatim të dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.
2. Autoritetet shtetërore qendrore dhe njësítë e vetëqeverisjes vendore bashkërendojnë punën, koordinojnë, harmonizojnë dhe integrojnë aktivitetet, me qëllim sigurimin e ruajtjes, mbrojtjes dhe administrimit të zonave të mbrojtura, si dhe krijojnë kushtet për aksesimin e tyre nga publiku.
3. Shteti siguron marrjen e masave për ruajtjen e zonave të mbrojtura në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura. Këto masa ruajtëse propozohen nga ministri përgjegjës për mjedisin, ministri përgjegjës për mbrojtjen, ministri përgjegjës për punët e brendshme dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

**Neni 4**

Pas nenit 4/2 shtohet nenit 4/3 me përmbajtje si vijon:

**Neni 4/3**  
**Aksesi i publikut në zonat e mbrojtura**

1. Zonat e mbrojtura në pronësi shtetërore janë të destinuara për shfrytëzim nga ana e publikut, në përputhje me nevojat e përdorimit, me përjashtim të rasteve kur nevojat e mbrojtjes e ndalojnë atë.

2. Për Zonat e mbrojtura në pronësi private, ndonëse i nënshtronen regjimit ligjor të parashikuar nga Kodi Civil, interesit publik që këto prona mbartin legjitimoni kufizimin e ushtrimit të tagrave të pronarëve të ligjshëm, në kushtet dhe mënyrat e parashikuara në legjislacion.
3. Pronarët dhe poseduesit e zonave të mbrojtura në pronësi private kanë detyrimin të garantojnë ruajtjen e këtyre pronave dhe vlerave që ato mbartin dhe të bashkëpunojnë me institucionet publike të specializuara për të kryer mbrojtjen, vlerësimin dhe aksesin në zonat e mbrojtura.

### **Neni 5**

Neni 6 ndryshon si më poshtë:

**Neni 6**  
Llojet e zonave të mbrojtura

Zonat e mbrojtura mjedisore, sipas llojit të interesit për të cilin ka marrë statusin e mbrojtjes, janë:

- a) zona të mbrojtura me interes lokal/bashkiak;
- b) zona të mbrojtura me interes kombëtar;
- c) zona të mbrojtura me interes ndërkombëtar ku bëjnë pjesë:
  - i) zonat “Ramsar”;
  - ii) zonat me interes për Komunitetin European (SACs), ku bëjnë pjesë zonat e veçanta të ruajtjes të habitateve dhe të shpendëve (SCI dhe SPAs);
  - iii) zonat me interes të veçantë ruajtjeje (zonat e rrjetit Emerald);
  - iv) zonat “Rezervë të biosferës”;
  - v) zonat e trashëgimisë natyrore.

### **Neni 6**

Në nenin 8, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me përbajtje:

“3/1. Në çdo rast, Bashkia përkatëse administron jo më pak se 20% e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura që janë në territorin e kësaj bashkie. Vlerësimi i këtij parashikimi kryhet sipas pikës 3 të këtij neni.”

### **Neni 7**

Neni 9 ndryshon si më poshtë:

**Neni 9**  
Objektivat e shpalljes së territoreve si zona të mbrojtura

“Territorët që shpallen zona të mbrojtura mjedisore, përvèç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, kanë për qëllim të përbushin objektivat e përgjithshëm si më poshtë:

- a) të mbrojë drejtimet e zhvillimit të tanishëm dhe të ardhshëm të pasurive kombëtare nëpërmjet ruajtjes dhe menaxhimit të ekosistemeve, habitateve e peizazheve përfaqësuese, si dhe integrimin e administrimit të tyre në politikat, planet, programet dhe veprimtaritë shtetërore, në nivel kombëtar e bashkiak;

- b) të sigurojë përdorimin e qëndrueshëm të elementeve të diversitetit biologjik, nëpërmjet përfshirjes së bashkive në vendimarrje dhe veprimtari të tjera që lidhen me zonat e mbrojtura, që përfshijnë caktimin dhe përvijëzimin e zonave, hartimin e planeve të administrimit të integruar dhe drejtimin e zonave të mbrojtura;
- c) të përcaktojë qartë objektivat e ruajtjes/ mbrojtjes për zonën e mbrojtur, duke përcaktuar shkakun e moslejimit të aktiviteteve në të;
- ç) të ruajë hapësirën e shpallur zonë e mbrojtur dhe përbërësit natyrorë të saj, me qëllimin për të siguruar vazhdimësinë dhe jetëgjatësinë elementeve të biodiversitetit, duke përdorur strategji menaxhimi të përshtatshme dhe administrim efektiv në kohë.
- d) të vlerësojë në përputhje me parimin e efektivitetit mundësinë për ndërhyrje brenda zonës, por pa u kufizuar në, zona urbane, rekreacioni, infrastrukturë rrugore, hekurudha, infrastrukture energjetike, perfshire impiantet për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme, infrastrukturës së naftës dhe gazit.
- dh) të vlerësojë përfshirjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të komunitetit të banorëve që jetojnë dhe janë pjesë e zonës së mbrojtur;
- e) të mos lejojë shfrytëzimin e tokës me teknologji intensive, me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjosore në biodiversitet, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme sipërfaqen e tokës sipas shkallës së mbrotjes së vendosur në aktin e shpalljes së saj;
- ë) të ndalojë rritjen dhe shpërndarjen e kafshëve dhe bimëve jovendase, kur ato sjellin ndryshime në biodiversitetin e zonës;
- f) të ndalojë ndryshimin e gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;
- g) të ndalojë çdo aktivitet që bie ndesh me objektivat e mbrojtjes së zonës.
- gj) të nxisë edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi zonat e mbrojtura;
- h) të nxisë kryerjen e aktiviteteve kërkimore - shkencore, si dhe monitorimin ekologjik të zonave të mbrojtura, në përputhje me objektivat e zonës së mbrojtur;
- i) të mundësojë kryerjen e aktiviteteve rekreative, në përputhje me objektivat e zonës së mbrojtur.”

#### Neni 8

Në pikën 6 të nenit 10 bëhen ndryshimet:

1. Në shkronjën “a” të pikës 6 fjalët “e planit kombëtar të rrjetit përfaqësues të këtyre zonave” zëvendësohet me fjalët “Planit Specifik të Zonave”.
2. Shkronja “ç” ndryshon si më poshtë:
  - ç) një raport vlerësimi për ndikimet në mijdis duke përfshirë identifikimin e proceseve dhe të kategorive të veprimtarive, të cilat mund ta kërcenojnë diversitetin biologjik, si dhe ndikimet e mundshme në zonë nga përdorimi i territorit të propozuar për t'u shpallur zonë e mbrojtur.
3. pas shkronjës “ë” shtohet shkronja “f” si më poshtë:
  - f) propozimin për veprimtaritë e lejuara të komunitetit dhe të bashkisë që rrjedhin nga vezhgimi social dhe ekonomik të popullatës vendore, që përfshin situatën e përdorimit të territorit të propozuar dhe ndikimin e mundshëm të zonës së mbrojtur në këto përdorime;”

## **Neni 9**

Neni 13 shfuqizohet.

## **Neni 10**

Në nenin 16 bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në gërmën “c” të pikës 2 pas togfjalëshit “... gazit me shtrirje të gjatë....” shtohet togfjalëshi përveç projekteve të miratuara nga KKT të propozuara nga Ministritë përgjegjëse ose bashkitë përkatëse ku të evidentohet rëndësia kombëtare e investimit dhe që investimi zbaton/respekton kriteret më të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe ndikimit më të ulët në natyrë dhe biodiversitet.”.
2. Gërma “d” shfuqizohet.
3. Në pikën 3 pas togfjalëshit “...çlodhëse të vizitorëve...” shtohet togfjalëshi “...dhe mundësive ekonomikë të komunitetit që jeton në zonë...”
4. Në gërm “c” të pikës 3 pas togfjalëshit “...drutë e zjarrit...” shtohet togfjalëshi “dhe veprimtari të tjera ekonomike të banorëve...”
5. Në pikën 4 shtohet gërma “f” me përbajtje  
“f) veprimtari të tjera ekonomike të banorëve dhe komunitetit si dhe bizneseve lokale, të cilat kanë marrë një miratim paraprak në bashkinë përkatëse”.

## **Neni 11**

Në pikën 3 të nenit 17 pas fjalisë së parë, shtohet fjalia si më poshtë”

“... Në rastet kur monumenti i natyrës është në zona të banuara, nuk aplikohet zona buferike e përcaktuar në këtë pikë.”

## **Neni 12**

Në nenin 19 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me përbajtje:  
“2/1. Në “Rezervatin natyror të menaxhuar/park natyror” ushtrohen veprimtari sipas përcaktimeve të këtij neni, neneve 33 dhe 49 të këtij ligji”.
2. Gërma “b” e pikës 3 shfuqizohet.
3. Pika 4 ndryshon si vijon:  
“4. Veprimtaritë e mëposhtme ushtrohen në këto zona duke marrë miratimin paraprak me shkrim të administratës së zonës së mbrojtur:  
 a) lëvizja dhe parkimi i automjeteve jashtë rrugëve publike dhe vendeve të caktuara për parkim;  
 b) mbledhja e bimëve, gjetjeve paleontologjike dhe e gurëve që nuk dëmtojnë habitatin natyror;  
 c) ngritja dhe funksionimi i objekteve për qëllime ushtarake dhe mbrojtjeje;  
 ç) vendosja e stendave, tabelave të dhënavë, reklamave, shenjave dhe posterave, me përashtim të atyre që jepin të dhëna për objektivat e mbrojtjes së rezervatit;

d) skitë, kampingjet dhe ndezja e zjarreve jashtë pikave të caktuara.”

### **Neni 13**

Në nenin 20, bëhen shtesat si më poshtë:

1. Gërma “c” e pikës 3 ndryshon si më poshtë:

“c) Përdorimin e tokës dhe kryerjen e aktiviteteve që zbatojnë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm me fokus zhvillimin ekonomik të zonës.

2. Pas shkronjës “dh” të pikës 3 shtohet shkronja “e me përbajtje:

“e) lejimin në përputhje me parimin e efektivitetit dhe planit të menaxhimit të ndërhyrjeve të lejuara urbane, rekreacionit apo industriale brenda zonës duke ruajtuar karakterin e zonës sipas parashikimeve të këtij ligji.

3. Pas pika 3 shtohet pika 3/1 me përbajtje:

“3/1. Në “Peizazhin e mbrojtur” ushtrohen veprimtari sipas përcaktimeve të këtij nenii, neneve 33 dhe 50 të këtij ligji”.

### **Neni 14**

Në nenin 21, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me përbajtje:

“ 3/1. Në “Zonën e mbrojtur të burimeve të menaxhuara” ushtrohen veprimtari sipas përcaktimeve të këtij nenii dhe nenit 33”.

### **Neni 15**

Në nenin 22, pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me përbajtje:

“ 2/1. Në “Zonën e mbrojtur detare” ushtrohen veprimtari sipas përcaktimeve të këtij nenii, nenit 33, nenit 34, si dhe rregullave përkatëse për nënzonimin në planin e menaxhimit”.

### **Neni 16**

Në nenin 23, pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me përbajtje:

“ 2/1. Në “Kurorën e gjelbër” ushtrohen veprimtari sipas përcaktimeve të këtij nenii dhe nenit 33”.

### **Neni 17**

Në nenin 24, pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me përbajtje:

“ 2/1. Në “Parqet natyrore bashkiake” ushtrohen veprimtari sipas përcaktimeve të këtij nenii dhe për aq sa është e mundur në nenin 33”.

### **Neni 18**

Në nenin 33, pas pikës 3 shtohen pika “ 4” dhe “5” me përbajtje:

“4. Ministria, AKZM-ja dhe pushteti lokal nxitin dhe përkrahin nisma, projekte, programe e veprimtari, që synojnë përmirësimin e treguesve ekologjikë e natyrorë të një zone të mbrojtur mjedisore ose që ndikojnë pozitivisht në to.

5. AKZM-ja dhe AdZM-ja hartojnë rregullore për vizitorët, e cila publikohet e shpallet në vende të dukshme të zonës.”

### **Neni 19**

Në pikën 5 të nenit 38, pas shkronjës “h”, shtohet shkronja “j” me përbajtje:

“j) vlerëson dhe i propozon Ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura rishikimin e planit të menaxhimit për zonën apo disa zona të mbrojtura.”

### **Neni 20**

Në nenin 42 bëhen ndryshimet:

1. Në shkronjën “f” të pikës 3, pas fjalëve “..veprimtari tradicionale” shtohen fjalët “..dhe ekonomike”.
2. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me përbajtje:  
“ 6. Plani i menaxhimit në cdo rast, mund të rishikohet me propozim të AKZM-së, apo AdZM-vë përkatëse, sipas procedurave të parashikuara në këtë ligj për miratimin e tij.”

### **Neni 21**

Në nenin 74, pas pikës 3 shtohet pika 4 si vijon:

3. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave, Ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura dhe KKT marrin masa që të reflektojnë ndryshimet e dispozitave të këtij ligji në aktet përkatëse që kanë miratuar në zbatim të këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 22**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E T A R I**

**LINDITA NIKOLLA**